



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:136094

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06222556

C.nr.3746/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.B. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B.¹, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 579.88 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.B. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore për vitin 2021, t'ia paguaj shumën prej 579.88 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 24.03.2024, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 24.03.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 579.88 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e punës – shef i SHMR në DRP në Gjilan, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, të njëjtit i takon shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të

¹ Në padinë fillestare është përfaqësuar me autorizim nga avokati F.S., i cili me email të datës 06.08.2024 ka njoftuar gjykatën se më datë 30.07.2024 ka dhënë betimin për noter, e me këtë rast ka dhënë dorëheqje nga pozita e avokatit. Për të gjitha lëndët civile ku ka qenë i autorizuar ka njoftuar se autorizimin ia ka bartur avokatit K.B.. Në autorizimin e bashkëngjitur shkresave të lëndës konstatohet përmbajtja “Nëse i autorizuari në fjalë për shkak të pengesave objektive nuk mund t'i ushtrojë autorizimet e dhëna nga unë, atëherë këtë autorizim mund ta bartë në persona të tretë pa pasur nevojë për pëlqimin tim si autorizimdhënës”.

kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shumës prej 579.88 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paga e trembëdhjetë mund të realizohet vetëm në momentin e aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave, për të cilën Policia e Kosovës ka bërë kërkesë për buxhet shtesë dhe i është refuzuar nga e njëjta. Ka theksuar se ky kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive ligjore por nuk përbën detyrim për të paditurën, si dhe vlerëson se i njëjti nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimitit paraprakisht. Ka konsideruar se kërkesa e paditësit është e parashkruar. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar te e paditura dhe për vitin 2021 është vlerësuar me vlerësim shumë të mirë (formulari i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunëve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale për këtë vit) dhe është paguar në shumën prej 579.88 euro në muajin dhjetor 2021 (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe

administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2021, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi se paditësi nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimimit, gjykata vlerëson se në kategorinë e të drejtave nga marrëdhënia e punës sa i përket kompensimit monetar, mund të adresohet kërkesa drejtpërdrejtë në gjykatë, pa u ndjekur fare procedura e brendshme administrative. Sa i përket pretendimit se kërkesa e paditësit është e parashkruar, gjykata vlerëson se bazuar në dispozitat nga neni 87 i Ligjit të Punës, kërkesa e paditësit nuk është parashkruar, pasi është paraqitur më datë 24.03.2024, ndërsa kërkon kompensimin e pagës së 13-të, për fundin e vitit 2021, pra brenda 3 vite, ndërsa sa i përket pretendimit se kompensimi i pagës së 13-të nuk paraqet obligim për të paditurën, gjykata vlerëson se punëdhënësi bazuar në UA nr.02/18 ka qenë i detyruar që të planifikojë buxhet për vitet 2018, 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3746/24, më datë 25.09.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

Numri i lëndës: 2024:136094
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06222556

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.